



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 34/2011
Prishtinë, më 04.10.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka , Sala Berisha- Shala, Berat Buzhala, Myzejene Selmani, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija, Hashim Deshishku dhe Lutfi Zharku.

Pjesëmarrës të tjerë: Flamur Keqa dhe Igballë Rexha - Jashari-MTI; Petrit Gashi, Ardian Kryeziu dhe Daglas Cruickshank nga USAID- BEEP; Lejla Selimi – OSBE dhe Natyra Kasumaj - KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Brikena Hoxha, konsulente e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29.09.2011;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë;
4. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29 .09.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 29.09.2011 u miratua pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë

Kryetari – Në emër të grupit të punës paraqiti Raportin me propozimamendamente të Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë. Në vazhdim shtoi se edhe pse ka një numër të madh të amendamenteve, Projektligji në esencë nuk ndryshon, por i është bërë një riformulim për çka është qartësuar Projektligji. Prezantoi 41 amendamente dhe për çdo amendament dhe kërkoi që nëse ka dikush vërejtje gjatë shqyrtimit, le t'i paraqesë.

Vërejtjet në amendamente

Fikrim Damka – Kërkoi që amendamentet 3 dhe 4 mos të aprovohen, sepse janë më shumë sqarues sesa që paraqesin diçka më të veçantë. Ai propozoi që të mbeten nënparagrafët 1.4 dhe 1.5 siç janë në Projektligj.

Propozimi nuk u përkrah nga Komisioni.

Ramiz Kelmendi - Kërkoi që në amendamentet 3 dhe 4 mos të jetë fjala “eksportim” dhe as “importim”, por vetëm “eksport” dhe “import” sepse janë të tepërta.

Propozimi nuk u përkrah nga Komisioni.

Kryetari – Kërkoi më shumë sqarime dhe hapi debat në lidhje me amendamentin 12, respektivisht përkufizimin “Kombi më i favorizuar”.

Ramiz Kelmendi – Theksoi se nuk ka nevojë të ndryshohet sepse në amendament është shumë mirë e specifikuar dhe nënkupton qartë se çka është “Komb më i favorizuar”.

Komisioni vendosi që në amendamentin 12, përkufizimi “Kombi më i favorizuar” të jetë si në vijim:

Kombi më i favorizuar – nënkupton konceptin siç parashikohet në nenin 16.

Si i tillë për shkak të referencave të shtohet edhe një amendament te neni 13 i Projektligjit si në vijim:

Amendamenti 30

Neni 13 në titull fjala “shtetit” zëvendësohet me fjalën “kombit”.

Visar Ymeri – Propozoi që te amendamenti 15, nënparagrafi 2.3 të jetë si në vijim:

2.3. Të gjitha masat mbrojtëse duhet të hartohen, zbatohen dhe publikohen në një mënyrë krejtësisht transparente.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

Ramiz Kelmendi – Propozoi që në amendamentin 28 tek “trajtimi vendor të mallrat e importuara dhe eksportuara” të vendoset një dispozitë apo paragraf që mbështet prodhuesit vendorë.

Flamur Keqa (MTI) – Sqaroi se me amendamentin 41 “*Koordinimi i politikës tregtare dhe mekanizmat lehtësues*” krijohet baza ligjore për mbështetje të prodhuesve vendorë po ashtu edhe përmes ligjeve tjera në fuqi.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë.

4. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme

Kryetari - I njoftoi anëtarët e Komisionit se mbikëqyrja e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme është paraparë edhe në Planin e punës së Komisionit për vitin 2011. Kërkoj që të formohet një grup i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit në fjalë.

Komisioni pas debatit njëzëri nxori këtë

V E N D I M

1. *Formohet grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme;*
2. *Grupi i punës ka këtë përbërje: Zenun Pajaziti- kryesues, Biserka Kostiq, Berat Buzhala dhe Lutfi Zharku, anëtarë;*
3. *Secili anëtar i Komisionit sipas interesimit mund t’i bashkëngjitet grupit të punës;*
4. *Grupi i punës në bashkëpunim me njësinë koordinuese të Komisionit të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

5. Të ndryshme

a) Aktivitetet e Komisionit

Kryetari- Propozoi që të fillohet me aktivitet e radhës lidhur me fushën që e mbulon Komisioni Funkcional.

Ramiz Kelmendi - Kërkoj që të organizohet një takim me të gjitha kategoritë e prodhuesve vendorë për t’u njoftuar më shumë me kërkesat e tyre dhe vështirësitë me të cilat po përballen. Më pas, z. Kelmendi shtoi se në Komision mund të shqyrtojmë kërkesat e prodhuesve vendorë për secilën kategori dhe mund t’ju ndihmojmë përmes legjislacionit favorizues.

Berat Buzhela - Propozoi që të organizohen dy apo tri konferenca lidhur me zhvillimin ekonomik për çdo dikaster që përfshinë zhvillimin ekonomik, për fushën që e mbulon Komisioni.

Visar Ymeri - Pajtohet me z. Kelmendi për iniciativën e takimeve me prodhuesit vendorë. Ai kërkoj që në këto takime të ketë edhe ekspertë nga këto fusha për të parë se çka mund t’ju

ndihmojmë me legjislacionin në fuqi dhe cilat janë mundësitë e ndihmës së Komisionit në këtë drejtim.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës të diskutohet agjenda për muajt e ardhshëm.

b) Kërkesa e NTPB “Hibridi”

Kryetari – I njoftoi deputetët se kemi një shkresë nga NTPB “Hibridi” për shkak të disa shkeljeve që iu kanë bërë kësaj ndërmartje nga AKP-ja, së paku sipas pretendimeve të tyre.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Të shikohen mundësitë ligjore që i lejon Rregullorja e Kuvendit në përgjigje të kërkesës së TPB “Hibridi”.

c) Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit